



ANEKS KONTRATA

Date: 19.11.2020

Në mes të

Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

Muhamet Muçiqi B.I. (NNP "Ndërtimtari") adresa **Podujevë** përfaqësuar nga **Muhamet Muçiqi**, me numër të regjistrimit të biznesit **810431453**, në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **Ndërtimi i tre pendave mbi lumin Llap në fshatin Dobërdol** me nr. të prokurimit **615-19-7383-5-2-1**, nr i brendshëm **615-19-123-521** të datës: **13.11.2019**, e cila kontratë është në realizim e sipër.

Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për **Ndërtimi i tre pendave mbi lumin Llap në fshatin Dobërdol -punë shtesë**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës **27.10.20120** me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. **Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: 5,933.87 €**
(pesëmijëenëntëqindetridhjetëtre euro tetëdhjetëeshtatëcent sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. [61519096521/5].
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	Rasim Fejza	Emri:	Muhamet Muçiqi
Pozita:	menaxher i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.11.2020	Data:	19.11.2020
Vula:		Vula:	